



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 102, Datë 30.04.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “KONTRATËS PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE TË BALANCIMIT (KAPACITETIT REZERVË DHE ENERGJISË BALANCUESE) TË SISTEMIT ELEKTROENERGJITIK PËR PERIUDHËN KOHORE 01.01.2018 – 31.12.2018” MIDIS OST SH.A. DHE KESH SH.A.

Në mbështetje të neneve 16; 20 gërma “h” dhe nenit 62, pika 3 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; VKM – së nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar; “Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, si dhe nenit 19 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 23.06.2016, bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 30.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike në lidhje me kontratën nr.1740/1 Prot, datë 29.03.2018 i KESH sh.a dhe nr. 2358 Prot., datë 29.03.2018, i OST sh.a, “Për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro – energjitik për periudhën kohore 01.01.2018 – 31.12.2018, midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.”,

Konstatoi se :

- Me shkresën nr. 1740/2 Prot., datë 30.03.2018, shoqëria “KESH” sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e Kontratës me nr. 1740/1, datë 29.03.2018 për shoqërinë “KESH” sh.a. dhe nr. 2358 Prot, për shoqërinë “OST” sh.a. “Për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro-energjitik”, për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018, të nënshkruar nga shoqëritë “OST” sh.a. dhe “KESH” sh.a..”
- ERE në zbatim të neneve 20 gërma “h” të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ka autoritetin për të miratuar kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

- ERE me vendimin nr. 194, datë 30.12.2016, ka vendosur “Miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat” për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2018.
- OST sh.a. në korrespondencë zyrtare ka bërë me dije se shërbimet ndihmëse dhe të balancimit mund të sigurohen vetëm nga njësitë gjeneruese në kaskadën e Lumit Drin, Fierzë dhe Vau i Dejës. Subjektet e tjera, të cilët kanë ndërtuar njësi gjenerimi të energjisë elektrike nuk kanë të instaluar pajisjet e nevojshme për të realizuar këtë proces. OST sh.a. bën me dije se KESH sh.a. është siguruesi më eficient dhe konstant i energjisë elektrike për qëllimet sa më sipër spjeguar, e që nuk rëndon në rritjen e kostove të OST sh.a..
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 3752/1 Prot., datë 26.12.2017 ka sugjeruar duke iu përmbajtur parashikimeve të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, që çmimi i vendosur sipas rregullave të tregut për sa i përket kontratës dypalëshe për sigurimin e shërbimit të balancimit dhe shërbimeve ndihmëse ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., duhet të bazohet në çmimin mesatar vjetor të ditës në avancë (DAM) të bursës Hungareze HUPX në momentin e nënshkrimit së kontratës dypalëshe.
- Kontrata e dërguar nga shoqëria KESH sh.a dhe e nënshkruar nga përfaqësuesit e të dyja palëve, në tërësinë e saj është në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjise elektrike"; me VKM-në nr. 244, datë 30.03.2015 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar; "Rregullat e përkohshme të Tregut të Energjisë Elektrike", miratuar me vendimin e bordit te ERE nr.139, datë 25.08.2016; “Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 193, datë 24.11.2017; “Kodin e Transmetimit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 186 datë 10.11.2017; vendimet nr. 23, datë 25.03.2009 dhe nr. 34, datë 13.05.2014, me të cilat ERE, ka vendosur rinovimin përkatësisht të licencave për prodhimin dhe tregtimin të energjisë elektrike, për KESH sh.a (ndryshuar me vendimin nr. 97, datë 17.06.2016, "Mbi miratimin e licences se tregtimit te energjise elektrike" dhe vendimin nr. 99, datë 17.06.2016, "Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.", vendimin e Bordit të ERE nr. 43, datë 15.03.2017, "Mbi miratimin perfundimtar te çertifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.", vendimin e Bordit të ERE nr. 134, datë 06.09.2017 "Mbi Licencimin e Shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit "OST" sh.a., në aktivitetin e Operimit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike", si dhe ka dakortësinë e tyre.
- Palët e kësaj kontrate janë subjekte juridike të legjitimuara për nënshkrimin e kontratës “Për sigurimin e shërbimeve të balancimit(kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro – energjistik për periudhën kohore 01.01.2018 – 31.12.2018” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a” duke patur parasysh që licenca e shoqërisë “OST” sh.a., në

aktivitetin e Transmetimit të Energjisë Elektrike është rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 134, datë 06.09.2017 dhe licenca e shoqërisë “KESH” sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike është rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 99, datë 17.06.2016.

- Çmimi për sigurimin e kapacitetit të Rezervës së Restaurimit të frekuencës në drejtim ngritje/ulje është 270 Lekë/MW/h. Çmimi për sigurimin e kapacitetit të Rezervës Zëvendësuese (RR) është 400 Lekë/MW/h. Çmimi i ofrimit të energjisë balancuese është ai i miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 193, datë 24.11.2017 “Mbi miratimin e Rregullave të Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike”.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kontratës “Për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektro – energjistik për periudhën kohore 01.01.2018 – 31.12.2018” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a dhe OST sh.a, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI